



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES

VENDIM

Nr. 8, datë 25.03.2025

PËR

**MIRATIMIN E KRITEREVE PËR PËRZGJEDHJEN E AUDITUESIT TË
BRENDSHËM TË SPECIALIZUAR, PËR AUDITIMIN E BRENDSHËM TË
AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE PËR PERIUdhËN 2025 - 2028**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 52, pika 1, shkronja “j” dhe të nenit 63, pika 2 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, të nenit 7, pika 6, të nenit 17, pika 1 dhe të nenit 18 të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 18 pika 2 të Rregullores të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm

V E N D O S I:

1. Të miratojë kriteret për përzgjedhjen e audituesit të brendshëm të specializuar, për auditimin e brendshëm të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, për periudhën 2025 - 2028, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi nga strukturat përkatëse të Agjencisë.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Shqipe Malaj

Donald Duraj

Sekretare

Kryetar

